



# NEWSLETTER

PRILL 2026

ISSUES #01

10 vite  
zëri i prodhuesve  
shqiptarë!

## SAMITI I DIASPORËS

Në një moment kyç për ekonominë shqiptare, Samiti i IV i Diasporës sollí në vëmendje sfidën e integrimit të biznesit në tregun european. Gjatë Forumit të Biznesit të Diasporës, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, Arben Shkodra theksoi se bizneset shqiptare duhet të investojnë në transformim, standarde dhe konkurrueshmëri për të qenë pjesë e tregut të BE-së.



## INTEGRIMI SIGURIA USHQIMORE

Transformimi i biznesit shqiptar ishte në fokus të një aktiviteti të organizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, nenvizoi se inovacioni, digjitalizimi dhe kërkimi shkencor janë kyç për konkurrueshmërinë e bizneseve shqiptare në tregjet e BE-së.



### Një identitet i ri për një etapë të re!

Në prag të 10-vjetorit, Shoqata “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë” ka nisur një proces transformimi të imazhit dhe identitetit të saj, duke hapur një kapitull të ri përfaqësimi, zhvillimi dhe vizioni për prodhuesit shqiptarë.

### PROPOZIMI: TË NGRIHET INSTITUTI I POLITIKAVE EKONOMIKE

Në një dalje në A2CNN, përballë Ministrit të Financave Petrit Malaj, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, propozoi ngritjen e një Instituti të Politikave Ekonomike, që do të ndihmonte në analizë, parashikim dhe orientim më të qartë të reformave.

### TEKNOLOGJI DHE PRODHIM

Durana Tech Park ka nënshkruar zyrtarisht një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) me Shoqatën Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. Ky partneritet bashkon teknologjinë me prodhimin – duke krijuar mundësi të reja për bashkëpunim, rritje dhe ndikim real në ekonomi.



## TREGU I BE-SË PLOT MUNDËSI, POR ME SFIDA TË SHUMTA!



### MESAZHET E SAMITIT

Samiti i IV i Diasporës ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme të muajit prill. Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, Arben Shkodra theksoi në Forumin e Biznesit të Diasporës se ndërrmarjet shqiptare duhet të nisin menjëherë përgatitjen dhe transormimin në mënyrë që të bëhen konkurruese në një treg të rregulluar dhe kërkues siç është ai i Bashkimit Europian.

### NË A2CNN PËR DIASPORËN DHE EKONOMINË

Investimet e diasporës kërkojnë drejtim të qartë! Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, Arben Shkodra, në një intervistë në A2CNN, theksoi se këto investime duhet të mbështeten mbi strategji dhe analiza konkrete, duke shfrytëzuar jo vetëm kapitalin, por edhe eksperiencën nga tregje të zhvilluara.

### MBI SIGURINË USHQIMORE

“Transformoni ndërmarrjet tuaja” – kjo ishte thirrja e Sekretarit të Përgjithshëm të Shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, drejtuar operatorëve të biznesit gjatë një aktiviteti zhvilluar nga AKU. Shkodra theksoi se pa transformim të brendshëm, bizneset nuk do t’ia dalin të dërgojnë prodhimet e tyre në tregjet e BE-së. Ai nënvizoi se transformimi duhet të përfshijë aspektin e organizimit të brendshëm, inovacionin dhe digjitalizimin, ndërsa prioritet i rëndësishëm duhet të jetë kërkimi shkencor.



### “A2CNN”, DEBAT ME MINISTRIN E FINANCAVE

Në një dalje në A2CNN, përballë Ministrit të Financave Petrit Malaj, u propozua ngritja e një Instituti të Politikave Ekonomike, që do të ndihmonte në analizë, parashikim dhe orientim më të qartë të reformave.



### BASHKËPUNIMI I MUAJIT

Durana Tech Park ka nënshkruar zyrtarisht një Marrëveshje Mirëkuptimi me Shoqatën Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. Nga inovacioni te prodhimi, po ndërtojmë lidhje më të forta që u japin bizneseve mundësinë të rriten dhe të konkurrojnë në tregjet globale.



info@prodhuesit.org



069 202 9944

